



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr._____, datë _____.____.2021

**“MBI PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR INFRASTRUKTURËN
E BRENDSHME PËR RRJETET E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE ME SHPEJTËSI TË LARTË DHE ADMINISTRIMIN
E PIKËS SË AKSESIT NË GODINA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 20, të Ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, me propozimin e ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina, sipas shtojcës 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Autoritetet planifikuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**RREGULLA
PËR INFRASTRUKTURËN E BRENDSHME PËR RRJETET
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ME SHPEJTËSI TË LARTË
DHE ADMINISTRIMIN E PIKËS SË AKSESIT NË GODINA**

1. Ky dokument ka si objekt përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë, për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.
2. Termat e përdorur në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, këtu e më poshtë ligji nr. 120/2016.
3. Në përputhje me pikën 1, të nenit 20 të Ligjit nr. 120/2016, ndërtesat shumëpërdorimëshe, godinat me shumë apartamente/njësi banimi ose struktura me disa biznese, të jenë të pajisura me pikë aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike.
4. Çdo godinë e re banimi ose biznesi, duhet të pajiset me pikën e aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë e cila të jetë pjesë e kushteve për pajisjen me Çertifikatën e Përdorimit sipas rregullave për zhvillimin e territorit, miratuar me VKM nr. 408 datë 13.5.2015 të ndryshuar.
5. Rrjet i komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë nënkupton rrjetin që mundëson shpejtësi më të madhe se 30 Mbit/s.
6. Pika e aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë është një kabinet në hyrje të godinës ose në një pjesë të saj, që përmban pajisjet e lidhjes me rrjetet e telekomunikacionit dhe që përmbush funksionet e mëposhtme:
 - a) bën ndërlidhjen e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të një sipërmarrësi të komunikimeve elektronike me infrastrukturën e brendshme të komunikimeve elektronike në godina;
 - b) mundëson kryerjen e instalimit, mirëmbajtjes, riparimit apo zhvendosjen e rrjeteve të ndryshme të kabllave (si kabëll bakri, kabëll koaksial, fibër optike etj);
 - c) mundëson integrimin me sistemet e citofonisë, kamerave të sigurisë apo pjesë të sistemeve inteligjente të godinave.
7. Në varësi të rrjeteve që do të instalohen në godinë, pika e aksesit në godinë është Kabineti i lidhjeve Telekomunikacion të Godinës (KTG), në formën e një kutie të vetme KTG, apo KTG me degëzim.
8. Instalimi i KTG-ve është i detyrueshëm në të gjitha godinat, përveç banesave individuale. Projektuesi duhet të marrë në konsideratë specifikimet teknike të përcaktuara për pajisjet dhe materialet, në përputhje me standartet e harmonizuara, kur të bëjë zgjedhjen për KTG.
9. Kur është e mundur, KTG-ja mund të ndahet në dy kabinete, KTG-ja e sipërme dhe KTG-ja e poshtme, në mënyrë që të lehtësohet futja e kabllave respektive të telekomunikacionit

dhe për të rregulluar sa më mirë rrjetin e kablllove në varësi të llojit të ndërtesës dhe teknologjisë së komunikimit. Në rastin e blloqeve të banimit me dendësi të ulët mund të instalohet një KTG e përbashkët.

10. Kabineti për lidhjet e telekomunikacionit të godinës (KTG), mund të jetë një kabinë e vetme ose një kabinë me karakteristikat e një rafti. Përmasat duhet të përshtaten në përputhje me kërkesat, karakteristikat dhe objektivat e dëshiruara të instalimeve dhe numrin e kateve, njësisive të godinës dhe të jenë të tilla që të mundësojnë aksesin e operatorëve të komunikimeve elektronike.
11. Pika e aksesit në godinë, duhet të ketë akses të kushtëzuar dhe duhet të përmbajë kuadrin dytësor të shpërndarjes (*Secondary Distribution Frame*) që mundëson akses për lidhjen e përdoruesve fundore (banorë apo biznes në godinë) në të paktën tri teknologji të parashikuara, përkatësisht: kabëll bakri, kabëll koaksial, Fibër optike.
12. Pika e aksesit në godinë, kabineti i lidhjeve të telekomunikacionit, duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme për vijimin në kuadrin dytësor të shpërndarjes (*Secondary Distribution Frame*) së rrjetit për secilën nga tre teknologjitë e mbuluara, duke mundësuar të paktën 2 operatorë për linjën e bakrit, 2 operatorë për kabllot koaksial dhe 2 operatorë për fibrën optike.
13. Operatori i rrjeteve të komunikimeve elektronike të autorizuar nga AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, ka të drejtën e aksesit në pikën e aksesit dhe në infrastrukturën fizike të ndërtesës me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të kërkuar dhe/ose kontraktuar nga përdoruesi fundor.
14. Vendndodhja e kuadrit/kutisë të shpërndarjes (*Secondary Distribution Frame*) duhet të zgjidhet në mënyrë të kujdesshme, në mënyrë që të jetë sa më pranë të jetë e mundur me tubacionin e rrjetit të teknologjisë përkatëse si dhe lehtësisht i aksesueshëm.
15. Për të dalluar tri teknologjitë janë të detyrueshme vendosja e emërtimeve përkatëse për Fibrën Optike (FO), për kabllin koaksial (Coax) dhe për linjën e bakrit (Cu).
16. Në godinat e reja shumëkatëshe dhe/ose shumëpërdorimëshe me mbi 10 kate rekomandohet të ketë dhomë teknike të telekomunikacioneve, ku të terminohen të gjitha kabllot për rrjetet e infrastrukturës së komunikimeve elektronike për godinën.
17. Dhoma teknike e telekomunikacioneve sipas pikës 16, duhet të jetë minimalisht me një sipërfaqe 5m² dhe duhet të përmbushë kërkesat minimale të mëposhtme:
 - a) Lartësi minimale prej 2.2 m;
 - b) Duhet të ketë të shkruar "Telekomunikacion" tek dera, me bojë që nuk fshihet;
 - c) Të ketë sistem ventilimi;
 - ç) Instalime në një lartësi të rekomanduar, për të siguruar se dhoma është mbi nivelin e ujit në tokë;
 - d) Dysheme të mbuluar me material anti-statik dhe të parrëshqitshëm;
 - dh) Ndriçim të përshtatshëm për të kryer punë që kërkojnë përpjekje vizuale të zgjatur, shqëruar me ndriçim emergjence në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike;
 - e) Instalim elektrik sipas ngarkesës së instaluar që ofron të paktën një qark me priza dhe një qark ndriçimi me sistem ndërprerje dhe mbrojtje;
 - ë) Një fikës zjarri.

18. Pika e aksesit në godinë, KGT konsiderohet pjesë e objekteve të përbashkëta të ndërtesave sipas Ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.
19. E drejta e aksesit në dhomën teknike, KGT apo në pikën e aksesit në godinë, me qëllim realizimin e lidhjes së shërbimeve publike të komunikimeve elektronike (si telefoni, Internet, IpTv) dhe/ose të mirëmbajtjes për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për operatorin e rrjeteve të komunikimeve elektronike është pa pagesë.
20. Çdo godinë e re pajiset me një infrastrukturë të brendshme fizike për komunikimet elektronike, nga pika e aksesit të godinës/kuadri i shpërndarjes, deri tek pika e shpërndarjes në banesë apo në mjedis biznesi të përdoruesit, që të jetë e gatshme për instalimin e rrjetit kabllor (bakër, fibër optike, kabëll koaksial etj.), me qëllim shpërndarjen e shërbimeve broadband me shpejtësi mbi 30 Mbps, deri në pikën fundore të rrjetit.
21. Në varësi të teknologjisë, kateve të godinës, distancave dhe numrit të përdoruesve të shërbimeve elektronike mund të vendosen kuadre ndërmjetëse të shpërndarjes në mënyrë që të ruhen parametrat teknike për çdo teknologji të përdorur.
22. Infrastruktura e brendshme fizike për rrjetet e komunikimit elektronik, është pjesë e projektit të ndërtimit të reja apo rikonstruksioneve dhe duhet të parashikojë shtrimin e tri linjave të ndara: fibër optike, kabëll bakri dhe kabëll koaksial në tuba të veçantë nga pika e aksesit të godinës/kuadri i shpërndarjes, deri në çdo përdorues fundor: banesë, apo njësi biznesi në godinë. Në çdo njësi banimi apo biznesi duhet të instalohet kaseta shpërndarëse e komunikimeve elektronike që mundëson marrjen e shërbimeve të shpejtësisë së lartë me të tre teknologjitë.
23. Sipërmarrësit ndërtues, detyrohen të ndërtojnë infrastrukturën e brendshme për rrjetin e komunikimeve elektronike të godinave të banimit apo shumëpërdorimëshe sipas këtyre rregullave dhe kërkesave.
24. Rregullat e parashikuara si më sipër do të aplikohen gradualisht për ndërtesat ekzistuese, kur ato janë objekt i punimeve të rikonstruksionit, riparimeve apo rindërtimit dhe punimeve rinovuese të mëdha.. Në këto raste KTG mund të instalohet dhe jashtë godinës.
25. Në infrastrukturën e brendshme fizike bëjnë pjesë vetëm elementët joaktivë të rrjetit të komunikimeve elektronike të cilat nuk kanë nevojë për furnizim me energji elektrike nga KTG-ja.
26. Projektimi sipas rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave për rrjetet e komunikimeve elektronike të miratuara në këtë dokument, u nënshtrohet rregullave dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe përbën kusht për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit. Mosparaqitja e planit/projektit sipas këtyre rregullave apo paraqitja në kundërshtim me rregullat dhe kërkesat e miratuara në këtë dokument, përbën shkak për refuzim të lejes së ndërtimit.

27. Ndërtimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe elementët shoqërues të tyre, bazohen në standardet e harmonizuara evropiane për ndërtimin e rrjeteve dhe instalimeve të brendshme në godina. Tabela me standardet e harmonizuara shqiptare jepet si referencë në fund të këtyre rregullave. Këto rregulla duhet të kuptohen si kërkesa minimale, pa paragjykuar zbatimin e rregullave të tjera që mund të jenë më të avancuara, me kusht që ato të jenë në përputhje me standardet e aplikueshme.
28. Rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë, për rrjetet e komunikimeve elektronike, zbatohen pa cënuar rregullat në fuqi mbi kushtet teknike, për ndërtimin e infrastrukturës së këtyre rrjeteve.
29. Specifikimet teknike për dimensionin e tubacioneve, rrjeteve kablore dhe kasetat e pikës së aksesit për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë në godinë, miratohen me rregullore nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. AKEP përgatit specifikimet teknike për rrjetin e brendshëm të komunikimeve elektronike të godinës dhe pikën e aksesit në godina, në koordinim me autoritetet e ndërtimit dhe ministrinë përgjegjëse, bazuar në standardet dhe praktikatat e mira evropiane.
30. E drejta e aksesit në infrastrukturën ekzistuese, në pikën e aksesit të ndërtesave ekzistuese dhe/ose ndërtesave të reja garantohet sipas Ligjit 120/2016 dhe rregullohet sipas rregullave të miratuara me këtë Ligj dhe aktet përkatëse.
31. Pika e aksesit në godinë, së bashku me rrjetin e brendshëm të komunikimeve elektronike, përfshirë tubacionet dhe linjat përkatëse, deri në pikën e degëzimit të tyre brenda njësite të ndara të kateve, janë pjesë e objekteve të përbashkëta të godinave dhe i nënshtrohen dispozitave të Kodit Civil dhe parashikimeve të Ligjit nr. 10112/2009 “Për Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.
32. Pika e aksesit në godinë, do të administrohet sipas dispozitave të legjislationit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit si dhe në përputhje me nenin 21, të ligjit nr. 120/2016. Administrimi i aksesit në godinë, dhe/ose dhomës teknike të telekomunikacionit bëhet nga administratori i godinës, i cili i mundëson aksesin sipërmarrësit të komunikimeve elektronike brenda 24 orëve nga kërkesa e këtij të fundit, për kryerjen e lidhjeve, mirëmbajtjeve mbi bazën e marrëveshjeve transparente dhe jodiskriminuese.
33. Në asnjë rast, këto marrëveshje nuk duhet të bëhen pengesë për operatorët e rrjetit të komunikimeve elektronike për aksesin në godinë dhe ofrimin e shërbimeve publike tek përdoruesit fundorë. Operatorët e rrjetit përballojnë me shpenzimet e tyre punimet për realizimin e lidhjeve apo mirëmbajtjen sipas rastit.
34. Administratori/shoqëria e administrimit dhe në mungesë të një administratori/shoqërie administrimi të regjistruar rregullisht, njësia administrative, i siguron operatorit të rrjetit të komunikimeve elektronike akses të pakushtëzuar 24 orë në pikën e aksesit apo në dhomën teknike kundrejt njoftimit paraprak. Punonjësi/punonjësit e operatorit duhet të jene të pajisur me dokumentin autorizues për kryerjen e punimeve në pikën e aksesit apo KTG.

35. Përcaktimet në këtë rregullore në lidhje me objektet e përbashkëta të godinave, përbëjnë norma detyruese në kuptim të ligjit nr. 10112 dt. 09.04.2009, neni 2, pika 15 e tij.
36. Çdo operatori të komunikimeve elektronike, duhet t'i garantohet një e drejtë e barabartë dhe e paanshme, për aksesin dhe përdorimin e infrastrukturës fizike në godinë të rrjetit të brendshëm të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore në pëputhje me nenin 21 të Ligjit 120/2016. Në rast të mungesës së infrastrukturës së gatshme në ndërtesë, sipërmarrësi i komunikimeve elektronike në marrëveshje me administratorin mund të ndërtojë me shpenzimet e veta rrjetin deri në ambientet e përdoruesit.
37. Në rastet kur operatorit i refuzohet e drejta e aksesit në pikën e aksesit në KTG apo nuk i lejohet të ofrojë shërbimin tek përdoruesi fundorsipërmarrësi i komunikimeve elektronike ka të drejtë t'i drejtohet AKEP-it për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. AKEP bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe mundësimin e aksesit apo mundësimin e realizimit të punimeve për realizimin e lidhjeve dhe shërbimit publik të komunikimeve elektronike deri në ambientet e përdoruesit.
38. Organet e qeverisjes vendore marrin masa për realizimin e aksesit apo lidhjeve deri në ambientet e përdoruesit dhe njëherazi marrin masa ndaj administratorit apo sipërmarrësit ndërtues për veprimet apo mosveprimet e këtij të fundit që nuk kanë lejuar aksesin në pikën e aksesit në godinë në kundërshtim me ligjin apo pengojnë ndërtimin e infrastrukturës kur kjo mungon në ndërtesë me qëllim ofrimin e shërbimit publik të komunikimeve elektronike.
39. Çdo lloj veprimi apo mosveprimi i administratorit të pikës së aksesit apo çdo lloj veprimi apo mosveprimi i cdo individi që merr atributet e administratorit, që pengon, nuk lejon apo nuk mundëson operatorin e komunikimeve elektronike për aksesin në infrastrukturën fizike ekzistuese kur nuk përbën shkelje penale, përbën shkelje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 36 të ligjit nr. 120/2016 .

Tabela me Standardet e Harmonizuara

Standardet e paraqitura në tabelën e mëposhtme, specifikimet teknike apo standardet e barasvlershme me to, përdoren si referencë për projektimin, ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në godina.

Standardi i Harmonizuar Shqiptar		
EN	Standardi Shqiptar	Titulli i Standardit
EN 50173	DS CLC/TR 50173-99-2:2010	Teknologji Informacioni - Ndërtimi një programi zbatimi BCT përmes kabllimit sipas EN 50173-4
	SSH EN 50117-4-1:2008	Kabllo koaksiale - Pjesa 4-1: Specifikim i seksionuar për kabllot në kabllimin BCT në përputhje me EN 50173 - Kabllot lidhës për përdorim të brendshëm në sisteme që veprojnë në frekuencat 5 MHz - 3 000 MHz
	SSH EN 50117-4-1:2008/A1:2013	Kabllo koaksiale - Pjesa 4-1: Specifikim i seksionuar për kabllot në kabllimin BCT në përputhje me EN 50173 - Kabllot lidhës për përdorim të brendshëm në sisteme që veprojnë në frekuencat 5 MHz - 3 000 MHz
	SSH EN 50173-1:2011	Teknologjia e informacionit - Sisteme kabllore të përgjithshme - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme
	SSH EN 50173-2:2007	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 2: Ambjente pune në zyra
	SSH EN 50173-2:2007/A1:2010	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 2: Ambjentet e zyrave
	SSH EN 50173-2:2007/A1:2010/AC:2 011	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 2: Ambjentet e zyrave
	SSH EN 50173-3:2007	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 3: Ambjente pune industriale
	SSH EN 50173-3:2007/A1:2010	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 3: Ambjente industriale
	SSH EN 50173-3:2007/A1:2010/AC:2 011	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 3: Ambjente industriale
	SSH EN 50173-4:2007	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 4: Banesat
	SSH EN 50173-4:2007/A1:2010	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 4: Shtëpitë
	SSH EN 50173-4:2007/A1:2010/AC:2 011	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 4: Shtëpitë
	SSH EN 50173-4:2007/A2:2012 SSH EN 50173-	Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme kabllimi - Pjesa 4: Shtëpitë Teknologjia e informacionit - Sisteme të përgjithshme

	5:2007	kabllimi - Pjesa 5: Qendrat e të dhënave
EN 50174	SSH EN 50174-1:2009	Teknologjia e informacionit - Instalime kabllimi - Pjesa 1: Specifikim instalimi dhe sigurimi i cilësisë
	SSH EN 50174-1:2009/A1:2011	Instalime kabllimi - Pjesa 1: Specifikim instalimi dhe sigurim i cilësisë
	SSH EN 50174-1:2009/A2:2014	Teknologjia e informacionit - Instalime kabllim - Pjesa 1: Specifikim instalimi dhe sigurim i cilësisë
	SSH EN 50174-2:2009	Teknologjia e informacionit - Instalime kabllimi - Pjesa 2: Planifikimi i instalimeve dhe praktika në brendësi të ndërtesave
	SSH EN 50174-2:2009/A1:2011	Teknologjia e Informacionit - Instalime kabllimi - Pjesa 2: Planifikimi i instalimit dhe praktika të ndjekura në brendësi të ndërtesave
	SSH EN 50174-2:2009/A1:2011/AC:2011	Teknologjia e Informacionit - Instalime kabllimi - Pjesa 2: Planifikimi i instalimit dhe praktika të ndjekura në brendësi të ndërtesave
	SSH EN 50174-2:2009/A2:2014	Teknologjia e Informacionit - Instalime kabllimi - Pjesa 2: Planifikimi i instalimit dhe praktika të ndjekura në brendësi të ndërtesave
	SSH EN 50174-3:2013	Teknologjia e informacionit - Instalimet kabllore - Pjesa 3: Planifikimi i instalimeve dhe praktikrat që përdoren jashtë ndërtesave
	SSH EN 50174-3:2013/A1:2017	Teknologji informacioni - Instalime kabllore - Pjesa 3: Planifikimi i instalimeve dhe praktikrat që përdoren jashtë ndërtesave
EN 50346	SSH EN 50346: 2002	Teknologjia e informacionit - Montimi i sistemit të kabllave - Provat e sistemit të kabllave të instaluar
	SSH EN 50346:2002/A1:2007	Teknologji informacioni - Instalime kabllimi - Kryerja e provave mbi kabllimin e instaluar
	SSH EN 50346:2002/A2:2009	Teknologjia e informacionit - Montimi i sistemit të kabllave - Prova të sistemit të kabllave të instaluar
EN 50310	SSH EN 50310:2010	Zbatimi i lidhjes dhe tokëzimit ekupotencial në ndërtesa me pajisje të teknologjisë së informacionit
	SSH EN 50310:2016	Rrjete të lidhjeve të telekomunikacionit për ndërtesat dhe strukturat e tjera